



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA GJIROKASTËR
KËSHILLI BASHKIAK**

VENDIM

NR 74, DATË 31.10.2024

“PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR 113, DATË 14.12.2023 “PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT AFATMESËM 2024-2026 DHE BUXHETIT VJETOR 2024”.

Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e datës 31.10.2024 pasi shqyrtoi materialin e paraqitur “Për një ndryshim në vendimin nr 113, datë 14.12.2023 “Për miratimin e programit afatmesëm 2024-2026 dhe buxhetit vjetor 2024”. Në zbatim të ligjit nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjit nr 68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, udhëzimit nr 09. datë 23.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, si dhe në mbështetje të VKB nr 100, datë 16.12.2022 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2023-2025 dhe buxhetit vjetor 2023”, VKB nr 36, datë 28.04.2023 “Për një shtesë në buxhetin 2023 për projektin “Konstruksionin e tregut local Rom ne Gjirokastrë Roma on market dhe projekti Romacted”, VKB nr 79, datë 05.10.2023 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr 100, datë 16.12.2022 “Për miratimin e programit afatmesëm 2023-2025 dhe buxhetit vjetor 2023” me qëllim implementimin e projektit me financim të huaj “Askush të mos mbetet pas-programi i përbashkët LOKB-së (LNB2) dhe financimi i kostove locale për “Roma on market” dhe “Romacted””, VKB nr 113, datë 14.12.2023 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2024-2026 dhe buxhetit vjetor 2024”.

VENDOSI:

1. Të miratojë ndryshimet në vendimin nr 113, datë 14.12.2023 “Për miratimin e programit afatmesëm 2024-2026 dhe buxhetit vjetor 2024” si më poshtë;
Pakësohet
Programi AB115 Kap. 05 Art 602 Produkti V014AAE në shumën 1,124,000 lekë.
Shtohet
Programi AB115 Kap. 05 Art 605 Produkti V014AAE në shumën 1,124,000 lekë.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet ekzekutivi.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETARI I KËSHILLIT

Merita Isaraj

Sekretar i Këshillit

Etleva Yzo

